



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-143
Prishtinë, më 14 dhe 15 nëntor 2013

PROCESVERBAL

**I SEANVCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHE 15 NËNTOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaku, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Myzejene Selmani, Enis Kervan, Blerta Deliu-Kodra, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Suzan Novobërdaliu, Adem Grabovci dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me kohën kur do të realizohet premtimi për vënien e pllakave përkujtimore, dhënë qytetarëve të cilët i kishin lëshuar shtëpitë e tyre për zhvillimin e procesit mësimor gjatë viteve të '90-ta. Ministri Ramë Buja nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci në lidhje me kompensimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshri në Gjakovë, Rahovec dhe Istog.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me aksionin e ndërmarrë nga ministria që ai drejton për spërkatjen e vendeve endemike me rriqra.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiç në lidhje me hapat që ka ndërmarrë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Ministri Nenad Rashiç iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me shkeljen e Ligjit për lojërat e fatit nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila subjekteve ekonomike u lëshon licenca për hapjen e lokaleve në afërsi të objekteve edukative-arsimore.

Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Suzan Novobërdaliu parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se a janë ndërmarrë hapa në lidhje me deklaratën e prokurorit serb për ndjekjen e krimeve të luftës.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor i Auditimit për vitin 2012,
11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës,
13. Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
14. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
15. Emërimi i 2 (dy) anëtarëve të Bordit të RTK-së.

3. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 12, 19, 26 shtator dhe 2 tetor 2013 pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi theksoi se ky Projektligj përcakton më qartë kompetencat e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe mbrojtjen e subjekteve ekonomike nga konkurrenca jolojale dhe rregullon përjashtimet grupore, përgjegjësitë e administratës funksionale dhe sanksionet e personit përgjegjës të ndërmarrjes në rast se është i involvuar në shkelje të rënda apo të lehta.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit dhe ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ramiz Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani; në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe deputetët Afërdita Berisha-Shaqiri dhe Hashim Deshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, theksoi se arsyeja për nxjerrjen e Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent qëndron në fuqizimin e kornizës ligjore me të cilën themelohet kjo agjenci, e cila është funksionale, pra me këtë projektligj rregullohet mënyra e themelimit, organizimi, strukturimi, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e financimit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe deputeti Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 68,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, theksoi se qëllimet kryesore që synojnë të arrihen me këtë projektligj janë: Harmonizimi i legjislacionit kundër korrupsionit

me legjislacionin penal në fuqi, përkatësisht me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, sipas të cilave sanksioni për veprën penale, konflikt interesi, është rritur në masë të dukshme dhe në rastet e caktuara kjo vepër është përcaktuar si vepër penale, përmbushjen e kriterëve dhe rekomandimeve që dalin nga studimi i fizibilitetit për Kosovën dhe përmbushja e kërkesave që kanë bërë agjencitë e ndryshme përfshirë Agjencinë Kundër Korrupsionit; përfaqësuesit e prokurorive dhe gjykatave si dhe përfaqësuesit e EULEX-it lidhur me ndryshimet në ligjin që rregullon parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion; Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Suzan Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 62,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për aktet normative.

Ministri Hajredin Kuçi theksoi se me këtë projektligj rregullohet hierarkia e akteve juridike, përgatitja dhe publikimi i teksteve të konsoliduara të akteve normative, si dhe përcaktimi i autoritetit përgjegjës për nxjerrjen e akteve normative, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal dhe parandalon konfliktin ndërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve tjera vendore.

Për më shumë, nëpërmjet këtij projektligji aktet normative rregullohen që nga parimet e tyre, që nga hartimi, nxjerrja, miratimi, publikimi i tyre dhe llojet e hierarkisë në aktet normative.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për aktet normative.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion dhe Grupit Parlamentar të LDK-së; Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për aktet normative.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 59,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për aktet normative.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Ministri Hajredin Kuçi theksoi se me këtë projektligj mosdeklarimin i pasurisë apo deklarimi i rrejshëm shndërrohen nga kundërvajtja në vepër penale, si dhe harmonizohen rekomandimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të përfaqësuesve të Prokurorisë, të sistemit gjyqësor dhe të EULEX-it.

Në këtë projektligj është rritur numri i personave të cilët detyrohen ta deklarojnë pasurinë e tyre, duke përfshirë kryetaren dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të emëruarit e presidentëve dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të universiteteve publike, si dhe është zgjeruar rrethi i anëtarëve të familjes së personave, të cilët detyrohen të bëjnë deklarimin e pasurisë.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion; Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Suzan Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe deputeti Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 69,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët se raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 ka qenë i radhitur në seancën plenare të datës 12 shtator 2013, por me kërkesën e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike është hequr nga rendi i ditës me qëllim që të plotësohet edhe me raportin e auditimit për vitin 2010 dhe 2011.

Në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, raportin me rekomandime e paraqiti Idriz Vehapi, kryetar i këtij komisioni, i cili i ftoi deputetët për miratimin e këtij raporti.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, deputetja Safete Hadërgjonaj theksoi se ky komision e ka përcjellë gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës dhe e përkrah miratimin e këtij raporti.

Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012, deputeti Ali Sadriu theksoi se ky komision i ka rekomanduar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm që të bëjë një auditim të performansës për punën e RTK-së.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Milivoje Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe deputetët Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Ramiz Lladrovci, Emilija Rexhepi dhe kryetari Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 27,
Kundër----- 34,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e nuk miratoi raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012.

10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Auditori i Përgjithshëm Lage Olofsson e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012, i cili është dhënë i plotë në transkript.

Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012, deputeti Ali Sadriu theksoi se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në punën e saj ka shënuar progres dhe i ftoi deputetët për miratimin e këtij raporti.

Kryesuesi Xhavit Haliti e hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Mursel Halili, emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe deputetja Valbona Dibra dhe ministri Fadil Ismajli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme plenare, në orën 17:15 minuta.

* * *

E premte, më 15 nëntor 2013

Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 14 nëntor 2013

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara së seancës së filluar më 14 nëntor 2013.

10. Votimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012

Kryetari e hodhi në votimi miratimin e raportit vjetor të Auditimit për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 62,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Auditimit për vitin 2012.

11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që t'i propozojnë anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Pas propozimeve të anëtarëve të këtij komisioni nga grupet parlamentare, Kryetari hodhi në votim miratimin e propozimeve.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 69,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Lirije Kajtazi, nga GP i LDK-së, zëvendëskryesuese,
3. Ramë Vataj, nga GP i PDK-së, anëtar,
4. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Afrim Kasolli, nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar,
6. Teuta Haxhiu, nga GP i AAK-së, anëtare,
7. Jeton Svirca, nga GP Koalicioni për Kosovë të Re, anëtar,
8. Duda Balje, nga GP i "6+", anëtare, dhe
9. Milivoje Stojanović, nga GP SLS-ZB, anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kërkoi nga grupet parlamentare që t'i propozojnë anëtarët Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Pas propozimeve të anëtarëve të këtij komisioni nga grupet parlamentare, kryetari e hodhi në votim miratimin e tyre.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 74,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në këtë përbërje:

1. Ramë Vataj, nga GP i PDK-së, kryesues,
2. Armend Zemaj, nga GP i LDK-së, zëvendëskryesues,
3. Xhevahire Izmaqu, nga GP i PDK-së, anëtare,
4. Haki Demolli, nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Albana Gashi, nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare,
6. Teuta Haxhiu, nga GP i AAK-së, anëtare,
7. Suzan Novobërdaliu, nga GP Koalicioni për Kosovë të Re, anëtare,
8. Mursel Halili, nga GP SLS-ZB, anëtar,
9. Enis Kervan, nga GP "6+", anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që të veprojë në pajtim me nenin 6 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

13. Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, mbështetur në Ligjin për prokurim publik, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t'ia propozojë anëtarët e Organit Përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mbështetur në përfundimet e Kryesisë së Kuvendit, ia ka propozuar Kuvendit tre gjykatës për Organin Përzgjedhës të Pavarur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Goran Marinkoviq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 58,
Kundër ----- 13,
Abstenime -----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur lidhur me emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

I. Anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur emërohen:

1. Valdete Daka, gjyqtare nga Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Asllan Krasniqi, gjyqtar nga Gjykata Themelore në Prishtinë,
3. Nebojsa Boriçi, gjyqtar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

II. Kërkohet nga anëtarët e Organit Përzgjedhës të Pavarur që mbështetur në nenin 100.4 të Ligjit nr. 03/L-241 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, ta shqyrtojnë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

14. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur me dispozitat e Ligjit për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë punën bujqësore dhe atë komerciale, si dhe ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Kuvendit ia ka parashtruar propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Në emër të Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi theksoi se ky komision e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe ka konstatuar se ka bazë kushtetuese dhe ligjore dhe i ftoi deputetët për votimin e këtij propozimi.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës:

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 58,
Kundër----- 13,
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Ujup Krasniqi dhe Ismajl Osdaudaj emërohen anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

2. Mandati i të emëruarve nga pika një (1) e këtij vendimi zgjat një (1) vit.

15. Emërimi i 2 (dy) anëtarëve të Bordit të RTK-së

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, deputetja Xhevahire Izmaqi para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Kryetari më pas i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës dhe me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës:

- Prej katër (4) kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad hoc, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Kuvendi zgjedh dy (2) anëtarë.

- Për pozitën e anëtarit nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë, prej dy (2) kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad hoc, Kuvendi zgjedh një (1) anëtar.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Sabri Hamiti, Emilija Rexhepi dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës dhe i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e formoi Komisionin votues, në këtë përbërje:

1. GP PDK - Blerta Deliu-Kodra,
2. GP LDK - Hashim Deshishku,
3. GP “Vetëvendosje” - Albana Fetoshi,
4. GP AAK - Kymete Bajraktari,
5. G/P Koalicioni Kosova e Re - Jeton Svirca,

6. GP SLS - Jelena Bontiq dhe

7. GP “6+” - Duda Balje.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një për votimin e anëtarëve të anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Blerta Deliu-Kodra.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 89 deputetë, ndërsa të pavlefshme ishin 7 fletëvotime.

Rezultati i votimit është si në vijim:

1. Naime Beqiraj ka fituar 46 vota,
2. Afërdita Maliqi ka fituar 63 vota,
3. Murat Musliu ka fituar 35 vota,
4. Besa Maxhuni ka fituar 6 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

I. Anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shumicë shqiptar zgjidhen:

1. Naime Beqiraj, me mandat 3 (tre) vjeçar,
2. Afërdita Maliqi, me mandat 3 (tre) vjeçar.

II. Obligohet Radiotelevizioni i Kosovës që të shpallë konkursin publik për zgjedhjen e një anëtari nga radhët e komunitetit serb.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale